

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencisë Kombetare të Mjedisit

Lenda: Kerkese për Zhvillimin e procedures së degjesës me publikun

Subjekti "ALB-IMPEX" Sh.a, me NIPT: K13513401O, njofton Agjencin Kombetare të Mjedisit për zhvillimin e procedures së informimit për publikun për aplikimin për Leje Mjedisi të Tipit B për instalimin:

Industritë energjetike, ID 1.9. Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: Pika b) Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant. **Leje Mjedisi tipi B.** Të gjitha instalimet

Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit, ID 7.3, pika c) Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi. **Leje Mjedisi tipi B.** Të gjitha instalimet, me vendndodhje *Fier, Qender – FIER, Sheq i Madh Magazine, kilometri 2 rruga Fier – Lushnje.*

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, datë 25/06/2014, "Për miratimin e kerkesave të posacme për shqyrtimin e kerkesave për leje mjedisi të tipeve A, B , për transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, të kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave per shqyrtimin e tyre nga autoritetet koompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKB-ja, te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B,dhe sipas pikes 2 te ketij kreu po ju bashkanjitim dokumentin e kerkuar:

1. Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose Tipi B";
Aplikim për Leje Mjedisi të Tipit B:
2. Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
Shoqeria ALB-IMPEX, Shoqeri Aksionere. NUIS: K13513401O, data e themelimit 09/01/2006, me objekt aktiviteti: Tëgim me shumice, Import- Eksport dhe transporti i artikujve bitumit, mazutit dhe nënprodukte te tjera te naftes. Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze.
3. Adresën e vendodhjes së instalimit;
Adresa: Fier, Qender – FIER, Sheq i Madh Magazine, kilometri 2 rruga Fier – Lushnje.
4. Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
Shpërndarja dhe magazinimi i mazutit dhe bitumit në cisternat e stacionit të furnizimit dhe tregtim me shumice i artikujve bitumit, mazutit dhe nënprodukte te tjera te naftes. Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze.
5. Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
6. Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkomunikim, kur kërkohet procedura e VNM-së;
7. Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Mjedisit, , afatet janë sipas Kreut III, pika 10 e VKM Nr. 419, datë 25.6.2014 e ndryshuar.
8. Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit; info@akm.go.al

Përfaqësuesi i shoqërisë ALB-IMPEX sh.a.
(Harilla Marku)

Nr. kontakti
0682070560

1. **KËRKESA PËR FUNKSIONIMIN E INSTALIMIT** “Shpërndarja dhe magazinimi i mazutit dhe bitumit në cisternat e stacionit të furnizimit dhe tregtim me shumice i artikujve bitumit, mazutit dhe nenprodukte te tjera te naftes, si dhe Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze” është për aplikim **për leje të re mjedisore të Tipit B**”; sipas Shtojces 1, të Ligjit Nr. 52/2020, date 30/04/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar,

	ID	Veprimtaria	Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B
Industritë energjetike	1.9	Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: b) Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant.	Të gjitha instalimet
Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit	7.3	c) Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.	Të gjitha instalimet

2. **TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-se**

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K135134010			
2. Data e Regjistrimit	13/11/2001			
3. Emri i Subjektit	ALB-IMPEX			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	09/01/2006			
6. Kohëzgjatja	Nga: 09/01/2006 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Fier Qender - FIER Sheq i Madh Magazine, kilometri 2 rruga Fier Lushnje			
8. Kapitali	70.000.000,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	100000000.0000			
10. Numri i aksioneve:	2.000,000			
10.1 Vlera nominale:	35.000,000			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Tregtim me shumice, Import- Eksport dhe transporti i artikujve bitumit, mazutit dhe nenprodukte te tjera te naftes. Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze. Tregti, import eksport te mallrave industriale etj.			

3. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

Emri i impiantit	<i>Shpërndarja dhe magazinimi i mazutit dhe bitumit në cisternat e stacionit të furnizimit dhe tregtim me shumice i artikujve bitumit, mazutit dhe nënprodukte të tjera të naftës, si dhe Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze</i>		
Adresa ku ndodhet instalimi	<i>Qender – FIER, Sheq i Madh Magazine, kilometri 2 rruga Fier – Lushnje, Fier</i>		
Koordinata e impiantit sipas sistemit GAUS KRUGE_ZONE_4	Pikat	X	Y
	1	43 80 150	45 13 640
	2	43 80 290	45 13 610
	3	4380 285	45 13 565
	4	43 80 140	45 13 595
Kategorite e veprimtarive industriale të cilat duhet të kerkojne leje mjedisi	<p>ID. 1.9. Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj; Pika b) Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant. <i>Leje Mjedisi Tipi B. Te gjitha instalimet.</i></p> <p>ID. 7.3. pika c) Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi. <i>Leje Mjedisi Tipi B. Te gjitha instalimet.</i></p>		



Pamje nga Google të zonës në studim ku kryhet aktiviteti (© S. Guri, 2022)

4. PËRSHKRIMI I VEPRIMTARISË QË ZHVILLOHET NË IMPJANT;

AKTIVITETI: Shpërndarja dhe magazinimi i mazutit dhe bitumit në cisternat e stacionit të furnizimit dhe tregtim me shumice i artikujve bitumit, mazutit dhe nenprodukte te tjera te naftes, si dhe Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze. Sipërfaqja e kompleksit është 4164m².

Adresa: Qender – FIER, Sheq i Madh Magazine, kilometri 2 rruga Fier – Lushnje, Fier.,

Subjekti: ALB-IMPEX, sh.a. me NIPT: K13513401O

Administrator: Harilla Marku;

Hyrje

Profili i shoqerise “ALB-IMPEX” sh.a.

Kjo shoqeri eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit per aktivitetin Tregtim me shumice, Import- Eksport dhe transporti i artikujve bitumit, mazutit dhe nenprodukte te tjera te naftes. Prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze. Tregti, import eksport te mallrave industriale etj.

Objekti ku zhvillohet aktiviteti për **Tregtim me shumice, Import- Eksport dhe transporti i artikujve bitumit, mazutit dhe nenprodukte te tjera te naftes dhe prodhimi dhe tregtimi i emulsioneve bituminoze** të shoqërisë “ALB-IMPEX” sha është i pozicionuar në zonën e Sheqit, Fier Adresa: Bashkia Fier, Sheq i Madh Magazine, kilometri 2 rruga Fier - Lushnje.

Kompania ALB-IMPEX Sha, zhvillon aktivitetin ne fushen e Tregtim me shumice, Import-Eksport dhe transporti i artikujve bitumit, mazutit dhe nenprodukte te tjera te naftes dhe prodhim i emulsioneve bituminoze , i regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me NIPT: L41513004O, qe prej dates 09/01/2006. Subjekti ne fjale eshte duke u pajisur me Leje Mjedisi tipi B ne zbatim te dispozitave ligjore, perkatesisht Ligjit Nr. 52/2020 datë 30.04.2020 për një ndryshim në Ligjin 10448 “Per Lejet e Mjedisit” ne Leje Mjedisi tipi B.

Impianti i instaluar nga Subjekti “ALB-IMPEX” sh.a. konsiston në një kompleks magazinimi të produkteve me bazë naftë si bitumin dhe mazutin me ane të tankerve cistern me sasi prej 3050m³ që më pas tregtohen dhe prodhimi i emulsionit bituminoz që u shërbenë klientëve për furnizimin me primer, e cila përdoret ne shtrimet paraprake të rrugëve, duke përbushur të gjitha kërkesat në bazë të kushteve teknike, mjedisore.

Operatori e zhvillon aktivitetin ne nje siperfaqe te rrethuar dhe godine 1 kat, e cila është e shtruar me beton dhe ploteson te gjitha kerkesat per te zhvilluar kete aktivitet. Vend-ndodhja është në një zonë fushore industriale me objekte dhe aktivitete ekonomike të tjera si zonë industriale dhe shërbimi.

Aktivitetet që zhvillonë kompania ALB-IMPEX. sh.a. në impiant janë si më poshtë;

1. Grumbullim dhe magazinim në enë të veçanta tip tanker rezervuar të lëndës mazut për shitje me kapacitet depozitues 1500m³;
2. Grumbullim dhe magazinim në enë të veçanta tip tanker rezervuar të lëndës bitum për shitje me kapacitet depozitues 1550m³;
3. Linjë prodhimi të emulsionit primer para bituminoz per lidhje te asfaltit me shtresen rrugore;

Lënda e parë Kompania e merr nga Fieri, Ballshi dhe Selaniku.



Lista e disa nga produkteve kryesore te linjes se tregimit te nenprodukte te naftes.

Elementet perberes te procesit te furnizimit me mazut dhe bitum per shitje

Procedurat e punes:

- Magazim bitumi ne çisterno prej 1000 ton dhe magazinim mazuti ne çisterno prej 500 m³, te cilat shiten si produkt i gatshem ;
- Pergatitja e lendes se pare asfalt –beton, primer;
- Prodhim primer proces teknologjik me 2 vaska prej çeliku 4 m³ secila perzihet aditiv (interpit) interal, produkt i certifikuar vjen nga Milano Itali, kompani e akredituar dhe çertifikuar, analizat behen ne Itali, lenda baze vjen me logon e CE.
- Perdoret gas butan si lende e pare per ngrohjen e bitumit.
- Temperatura e produktit te gatshem eshte 88 °C
- Asnje ankese nga banoret qe jane me shume se 500 m larg.
- Zone industriale e rrethuar me bimesi te larte deri ne agrume e ullishte.

Pajisjet kryesore të impiantit

1. Rezervuari i mazutit (siperfaqesor) me kapacitet 1000 ton me aksesoret e matjes dhe sigurise, (si manometer, nivel tregues, termometer), i mbeshtetur ne 2 jastek betoni;
2. Rezervuar celiku horizontal (siperfaqesor) per ruajtjen e bitumiut dhe nenprodukteve te saj me presion te avujve te ngopur jo më të larte se 2000 Pa.
3. Kaldaja e bitumit me kapacitet 1163Kw me temp max. 300°C me aksesoret e matjes dhe sigurise, (si manometer, nivel tregues, termometer),
4. Pompat e ujit ku janë të instaluara dy pompa me kapacitet 40 m³/orë;
5. Rezervuarë uji me kapacitet 50m³
6. Gjenerator shkume;
7. Rezervuarë i shkumës sintetike;
8. Lidhjet teknologjike të furnizimit me ujë dhe e injektimit të solucionit të shkumës nëpërmjet dhomave të shkumës, në rezervuarin e produktit.
9. Shkumë sintetike e tipit MENTYER 721 ose shkumë e llojit të ri- konsumi 6%, dmth solucion shkume me koncentrim 6%. Ezhektorët – 3000 m³ 6''/4'', 5000 m³ 8''/6''. Sasia e depozituar për luftim zjarri jo më pak se 30'

Ndertesat dhe infrastruktura

- Pika e shkarkimit te autoboteve;
- Sheshi per parkimin e automjeteve;
- Stacioni i pompave,
- Stacioni i ngarkimit te autoboteve,
- Godine per zyra dhe ambiente sherbimi
- Kabine gjeneratori,
- Ndertesa e mbushjes se autocisternave,
- Peshorja e autoboteve,

Gjithashtu ne kete ambient jane edhe hapsirat per levizjen e mjeteve , punonjesve dhe siperfaqet e gjelbra, oborri i cili eshte i gjelberuar anash me bimesine karakteristike te ketyre ambinteve.

5. PËRSHKRIMI I PROÇESEVE TË PUNËS

Në realizimin e këtij aktiviteti, proceset kryesore teknike janë:

Linja e prodhimit te emulsionit bituminoz

Kjo linje është e prebere nga nje cistern ku ndodh perzjerrja e bitumit me aditiveve perkates per te fituar produktin primer. Me vëllim $V=6m^3$ është ndertuar mbi bazamente beton arme. Sheshi i depozitave eshte me permasa 6x5 metra brenda një dhome me lartesi $h=3m$. Sheshi i tyre është me shterse betoni prej 15cm me zgara hekuri.

Mjedisi pompe-kompresor

Mjedisi pompe-kompresor është ambjenti ku vendosen pompat dhe kompresorat te cilat sherbejne per ngarkimin dhe shkarkimin e emulsionit. Ky ambjent me permasa 2x3m dhe ndertohet ne nje bazament batoni. Ky mjedis ndertohet me kollona metalike, si dhe mbulohet me panel sanduic. Ky ambjent do te jete i tille qe te jete i hapur, si dhe te siguroj mbrojtjen e depozitave, duke vendosur rrjete metalike per mure te tij. Ne kete ambjent jane vendosur dhe pajisje kundra zjarrit, si dhe vendosja e sistemit te alarmit.

Pikat e ngarkim - shkarkimit të autoçisternave

Janë vende, ku bëhet lidhja e autoboteve për t'i ngarkuar ato me produkte, si dhe shkarkimit të tyre kur ato vijnë plot. Janë të pajisura me tubacione dhe armature, ku bëhet e mundur lidhja e autoboteve. Këto pozicione duhet të plotësojnë kushtet e mësipërme për pompat dhe t'u referohen kushteve e normave teknike.

Pika e ngarkimit te autoboteve

Ky objekt eshte afer stacionit te pompave dhe lejon qe te ngarkohen dhe shkarkohen autobotet. Me ane te tubave behet e mundur levizja e lengut per ngarkimin e depozitave dhe autoboteve.

Zyra dhe ambiente sherbimi

Eshte nje godine nje kateshe me permasa 3x3 metra. Ketu vendosen zyrat dhe ambjentet e sherbimit qe te jene te nevojshme per impiantin.

Furnizimi me energji elektrike dhe nderlldhja

Pjesa elektroteknike e projektit eshte perpunuar ne baze të të dhenave dhe kerkesave te detyres se projektimit dhe gjithashtu te zgjedhjeve teknike ne funksion te kategorise ndertimore. Ne perberje te pjeses elektrike te projektit perfshihen: zgjidhja e problemeve te furnizimit me energji elektrike te pajisjeve elektrike te ndricimit elektrik, te mbrojtjes nga renia nen tension, te mbrojtjes nga rrymat elektrostatische te objekteve te projektuara. Gjate projektimit jane shfrytezuar dokumentat normative veprues dhe normat nderkombetare te Komisionit Nderkombetar te Elektroteknikes (IEC).

Kabine gjeneratorit

Ky ambient është me permasa 10x7m. Kjo është ngjitur me godinen e administrates dhe do bëjë të mundur furnizimin me energji elektrike të gjithë impiantit.

Rezervuari i ujit

Rezervuari i ujit është me vëllim $V=150\text{m}^3$. Ky do të jetë i lidhur me impiantin e M.N.Z. dhe afër ka dhe stacionin e pompave të M.N.Z. të cilat bëjnë të mundur në çdo moment nga zjarret ndezja e dhe hapja e pompave. Rezervuari do të ketë një sipërfaqe 5x5m dhe thellesi $h=6\text{m}$. Ai ndërtohet me B/A si dhe muret e tij do të jenë me B/A

Transporti i brendshëm

Rrugët automobilistike në territorin e impiantit janë projektuar duke marrë parasysh shtrirjen e mjeteve teknologjike si dhe organizimin e shërbimit të mbrojtjes kundër zjarrit të objektit. Ata sigurojnë lidhje të domosdoshme midis linjave të objektit në teresi. Rrjeti i rrugëve automobilistike është parashikuar sipas skemës me hyrje dhe dalje të sigurte për të kryer transportin e nevojshëm të ngarkesave në vazhdimësi. Në rrugët me ngarkesën më të lartë janë ato të sektorit të hyrjes në impiant për mbushjen e autocisternave. Gjeresia e kalimeve të pjesëve të rrugëve kryesore është marrë 6 metra. Profili horizontal i të gjithë rrugëve automobilistike përbehet nga një shtresë dyfishe asfaltbetoni.

Mbrojtja e rezervuareve nga zjarri

Depozitat e rezervuareve janë instaluar duke respektuar me korrektesë normat teknike të mbrojtjes kundër zjarrit, pra me probabilitet të vogël të lindjes së zjarreve, të vendosur sipas skemës teknologjike të ndërtuar me konstruksion metalik, dhe të rrethuar me mur betoni në lartësi $h=1\text{m}$. Sheshi i tyre është me një shtresë betoni prej 15cm dhe me zgara hekuri. Bazamentet e depozitave ndërtohen me pilota ku janë tre çiftë pilotash, ku një çift pilote do të jenë për një këmbë metalike ose betoni për pilotat. Betoni i përdorur është i markës M350 për arsye sepse janë ndërtime speciale. Hapësira e krijuar dhe e venteluar në mënyrë natyrale, ndërmjet pareteve konstruksion metalik të rezervuarit dhe këmbës së betonit me gjeresi prej 800mm, krijojnë kushte të favorshme, për të mbajtur të freskët mjedisin përreth rezervuarit në çfarëdo periudhe të vitit si dhe për çdo mundësi lindje zjarri përreth.

Plani i organizimit të ambientit

Funksionimi i këtij impianti nuk do të krijojë shqetësime për terrenet rreth e rrotull gjatë procesit të funksionimit, pasi objekti përbën një kombinim të thjeshtë të pajisjeve teknologjike për depozitim të mazutit dhe bitumit. Gjatë kohës së operimit të objektit nuk krijohen dëmtime të tokës, pasi nuk ka mbetje dëmtuese që të shkarkohen në të, si në sipërfaqen në dispozicion, ashtu edhe përreth. Edhe në rast se ky aktivitet në një të ardhme, për arsye të ndryshme ndërpritet i gjithë sheshi do të jetë plotësisht i përdorshëm për çdo qëllim tjetër. Pjesa e lirë e tokës brenda sheshit të kompleksit në gjendjen e veprimtarisë intensive të objektit është plotësisht e përshtatshme për t'u mbjellë me bimësi, mbështetur kjo në faktin, që objekti nuk do të nxjerrë mbetje të dëmshme për mjedisin.

6. PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ

Industritë energjetike, ID 1.9. Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj:
Pika b) Shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant. **Leje Mjedisit tip B.** Të gjitha instalimet
Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit, ID 7.3, pika c) Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e

katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi. Leje Mjedisi tipi B. Të gjitha instalimet.

LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMESE DHE ENERGJIA E PERDORUR NGA IMPIANTI

Lëndet e para blihet nga subjektet e licensuara për prodhimin e tyre ne Fier, Ballsh dhe Selanik. Lëndët e para që grumbullohen dhe magazinohen shëbejne për tregëtim per shitjet klienteve privat. Lëdet e para që përdoren per magazinim dhe tregëtim jane;

- mazut;
- bitum;
- nenproduktet e naftes;
- Adetivë për prodhimin e emulsionit bituminoz,

Lëndët ndihmese që nevojiten për funksionimin e këtij aktiviteti janë;

1. Ujë nga rrjeti i ujësjesit,
2. Energji elektrike

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE MJEDISORE TË NJOHURA

të cilat kanë lidhje me kryerjen e aktiviteve në instalim, dhe përshkruani masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis.

Ndikimet në popullsi

Ndikimi në popullsi mund të jetë i formave të ndryshme, gjatë funksionimit të impiantit aksidentimi i banorëve nga mjetet e transportit në rrugë, aksidentimi i punëtorëve gjatë punës është një nga rreziqet kryesore sidomos nëse ata janë të pa trajnuar.

Lloji i ndikimit në shëndetin publik	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Krijimi i çfarëdo rreziku apo mundësie për dëmtimin e shëndetit të njerëzve			x	
Krijimi i raportit të njerëzve me rreziqet e mundëshme për dëmtimin e shëndetit publik				x

Ndikimet në Pejzazh

Nuk ka ndikime në peizazh, sepse zona në të cilën ndodhet objekti, nuk do të ketë ndikime të pjesshme, gjatë periudhës së funksionimit. Peizazhi nuk do të ndryshojë, mbasi aktiviteti kryhet ne ambint te mbyllur. Mbetjet e ngurta do të mblidhen përkohësisht në kazanët përkatës, në mënyrë që të jenë të gatshme për tu tërhequr nga Bashkia.

Lloji i ndikimit në tokë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshime topografike të terrenit				x
Prishja e tokës bujqësore				x
Ndotja e tokës nga rrjedhjet				x
Ndotja e tokës nga mbetjet e ngurta				x
Ndotja e tokës nga depozitimet e llumrave				x

Ndikimet nga Shkarkimet në Ajër

Ndikime në shkarkimet në ajër mund të vijnë, si nga PM10 dhe nga ngarkesat gjatë qarkullimit të automjeteve. Shkarkime të tjera të gazta si djegie karburantesh etj., nuk do të ketë nga ky aktivitet, për faktin se makinerite e linjes funksionojne me energji elektrike.

Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndotja e ajrit				x

Ndikimet e zhurmave gjatë punës

Dihet që gjatë funksionimit të impiantit do të kemi rritje të nivelit të zhurmave por brenda normave të zonave industriale dhe orarit të percaktuar sipas ligjit shqiptar, si pasojë e funksionimit të makinerive të prodhimit të reklamave.

Lloji i ndikimit në ndotjen nga zhurmat	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave				x
Rritja e nivelit të zhurmave, si rezultat i aktivitetit dhe makinave			x	
Rritja e nivelit të zhurmave për njerëzit				x
Niveli më i lartë i zhurmave për kafshët				x

Ndikime në transport

Do të ketë ndikim në rrugë, sepse do të shtohet aktiviteti i makinave, kur bëhet furnizimi me lende të pare mazut dhe bitum.

Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shtime të rëndësishme të qarkullimit të automjeteve			x	
Pakësime të vendqendrimeve të automjeteve apo nevoja për vendqendime të reja				x
Ndikime të rëndësishme në sistemin e komunikacionit				x
Ndryshime në qarkullimin apo lëvizjen e njerëzve				x

Ndikime në rrugët lokale

Lloji i ndikimit në interesin publik (infrastruktura)	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Ndryshimi i destinacionit të aktivitetit do të ketë nevojë për ndryshim në këtë fushë të interesit publik				x
Konsum të Energjisë elektrike			x	
Sistemin e komunikacionit				x
Sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza dhe të bardha				x
Sistemin e ujësjellësit				x
Mbetjet e letres, aluminit dhe kartonit dhe riciklimi i tyre			x	

Ndikimet në Trashëgiminë Kulturore dhe Arkeologjike

Ndikime në këtë aspekt nuk do të ketë, pasi në zonën përreth nuk ka zona me trashëgimi kulturore dhe arkeologjike.

Lloji i ndikimit për trashëgiminë kulturore	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo

Ndryshime apo dëmtime të zonave arkeologjike apo me vlerë historike e kulturore				x
---	--	--	--	---

Ndikimet në Florë e Faunë

Zona në të cilën funksionon linja është një zonë industriale dhe e varfër përsa i përket florës dhe faunës.

Lloji i ndikimit në florën dhe faunës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrimi i rëndësishëm i habitateve natyrore				x
Rrezikimi i ndërhyrjes në bimët e ujit				x
Ndërtimi i rrugëve të reja që kalojnë përmes zones së virgjër				x
Përçarje apo izolim të habitateve të egra				x
Interferencë midis rrugës natyrore të emigrimit të sisorëve				x

Ndikimet në ujë

Lloji i ndikimit në ujë	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Trajtimi i ujrave të ndotur				x
Ndotja e ujit prej pluhurit, hidrokarbureve, derdhjeve aksidentale dhe substancave të tjera				x
Ndikimi sekondar në ndotjen e ujit për toka bujqësore, ujrat nëntokësore, etj.				x
Modifikim në drenazhimin e ujrave natyrore				x
Ndotja e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga llumrat				x

Ndikimet në klimë dhe ajër

Ndikimet në klimë nuk do të ketë, sepse nuk do të prodhohet CO₂.

Ndikimet në tokë

Lloji i ndikimit në përfitimin e tokës	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Shkatërrim banesash				x
Ndryshime të rëndësishme në programet për të ardhmen e përdorimit të tokës				x
Rivendosje banesash				x
Shpronësime të tokës				x

Ndikime dytësore që lidhen me projektin

Lloji i ndikimit në energji	Identifikimi i ndikimit			
	Gjatë ndërtimit		Gjatë shfrytëzimit	
	Po	Jo	Po	Jo
Përdorim i sasive të mëdha të karburantit për energji				x

Rritje të rëndësishme të kërkesave për burime ekzistuese të energjisë apo kërkesave për tipe të reja të energjisë				x
---	--	--	--	---

MASAT PER MINIMIZIMIN E NDIKIMEVE MJEDISORE

Toka	
Perdorimi i tokes	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave te percaktuara; ➤ Zbatimi i kushteve teknike dhe standarteve; ➤ Mirembajtja dhe gjelberimi i siperfaqes.
Biodiversiteti	
Shtimi i vegjetacionit	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mbjellja e fidaneve te rinj, ne perimetrin rrethues te subjektit, nese eshte e nevojshme.
Cilesia e Ajrit	
Emetimeve ne ajer	Emetimet ne ajer do te monitorohen vetem ne ambientet e punes, sepse ne ambientin e jashtem nuk kemi indikator per monitorim.
Mbetjet	
Menaxhimi i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mirembajtja e koshave me ngjyra dhe ndarja e mbetjeve urbane qe ne burim.
Zhurmat	
Rritje e nivelit te zhurmave	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Kontroll periodik i pajisjeve operuese me qellim, minimizimin e emetimit te zhurmave.
Trafiku rrugor	
Trafiku rrugor	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Orinetimi i mjeteve qe ne hyrje te instalimit, nepermjet tabelave instruktuese.

PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Diferencimi i mbetjeve të gjeneruar brenda objektit të linjes, sipas perberjes mercologjike kryesore nëpërmjet instalimit të sistemit të Kontenierëve, transportimi i tyre periodik, përmes bashkëpunimit me NJQV-në (Bashkin) dhe subjekt të kontraktuar në grumbullimin e mbetjeve, duke zbatuar Strategjië Kombëtare të Mjedisit për Menaxhimin eMbetjeve.

Objektivat afatshkurtra dhe afatmesme të planit janë si më poshtë:

- Instalimi i sistemit me kontenier brenda zonës ku zhvillohet aktiviteti;
- Diferencimi i mbetjeve, sipas tre rrymave prioritare.
- Transportimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Vendore.
- Nëshkrimi i kontratave me biznesin e riciklimit për grumbullimin e mbetjeve teknologjike.
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe trajnimi i punonjësve të vetë shoqërisë, duke ofruar një efikasitet dhe efektivitet në diferencimin dhe menaxhimin të integruar të mbetjeve.

Plani i veprimit

Masat	Data e pritur e përfundimit	Personi përgjegjës
1. Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Mbetjeve	Menjehere pas pajisjes me leje mjedisi	Përfaqësuesi Ligjor
2.Ndërtimi i infrastrukturës së mbetjeve	Menjehere pas pajisjes me leje mjedisi	Përfaqësuesi Ligjor
3. Vendosja e Kontenierëve	Menjehere pas pajisjes me leje	Përfaqësuesi Ligjor

4. Kontrat me NjQV-të dhe Kompanit e Pastrimit	Menjehere pas pajisjes me leje mjedisi	Përfaqësuesi Ligjor
5. Trajnimi i Punonjësve	Cdo vit	Trajner të Specializuar, Grupi i Teknikëve
6. Kontrata me Bizneset e menaxhimit te mbetjeve	Cdo vit	Përfaqësuesi Ligjor

PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TE PROJEKTIT

Monitorimi bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë për vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku është instaluar impianti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Të krijojë regjistër të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.

Ndikimet Pozitive të projektit

Edhe pse është e pa evitueshme, që në rajon të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që:

- të ketë punësim të vazhdueshëm;
- të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;
- ndikimet mjedisore që identifikohen të eliminohen, reduktohen ose zbuten.

Duke patur parasysh vlerat jo të mëdha të territorit në gjendjen aktuale, mendohet se kompensimet dhe ndikimet e tjera pozitive, si punësimet, përmirësimet në infrastrukturë marrin një rëndësi të veçantë për komunitetin e rajonit. Këto ndikime nxisin edhe komunitetin për mbështetjen e investimeve.

Masa të tjera të planifikuara në përputhje me parimet e përgjithshme që rregullojnë detyrimet themelore të operatorit, dmth:

- janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre;*
- janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme*

PËRFUNDIME

1. Nga impianti nuk shkaktohet ndotje e konsiderueshme, në veçanti me anë të zbatimit të

- praktikave më të mira;
2. Impianti punon dhe menaxhon parametrat që sigurojnë mbrojtjen e tokës;
 3. Impianti punon dhe menaxhon parametrat që sigurojnë mbrojtjen e ujërave nëntokësore;
 4. Impianti punon dhe menaxhon parametrat që sigurojnë menaxhimin e përshtatshëm të mbetjeve të gjeneruara nga instalimi;
 5. Kompania dhe studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e aksidenteve dhe minimizimin e pasojave të tyre;
 6. Kompania dhe studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar kërkesat e përshtatshme për monitorimin e shkarkimeve, duke përcaktuar metodologjinë dhe frekuencën e matjeve, procedurën e vlerësimit, si dhe të sigurojnë se zotëruesi i lejes i jep AKM-së dhe ISHMPU-së të dhënat e kërkuara për të kontrolluar përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit të tipit B;
 7. Studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar që operatori t'i sigurojë rregullisht AKM-së dhe ISHMPU-së rezultatet e vetëmonitorimit të shkarkimeve;
 8. Studioja e realizimit të raportit Mjedisor për këtë impiant ka përcaktuar që operatori të informojë pa vonesë AKM-në dhe ISHMPU-në për çdo aksident, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për parandalimin e rreziqeve nga aksidentet madhore.

Edhe pse është e paevitueshme, që në Fier të shfaqen disa ndikime negative mjedisore e sociale, projekti do të bëjë që:

- Të ketë punësim, Të sigurojë investime të drejtpërdrejta në komunitetin lokal;

7. KONSULTIMET NDËRKUFITARE

Zona ku zhvillohet aktiviteti nuk i nënshtrohet procesit të konsultimit nderkufitar.

8. AUTORITETIN VENDIMARRËS PËR DHËNIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË DO TË NDIQEN;

Autoriteti miratues për dhënie e aktit të miratimit të lejes së mjedisit është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për tu pajisur me leje mjedisi të tipit B, me propozim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nepermjet Qendres Kombëtare të Biznesit.

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisi të tipi B është 40 dite pune.

9. ADRESËN E AKM-SË, KU PUBLIKU MUND TË DËRGOJË KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORMË ELEKTRONIKE, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit;

Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit: akm.gov.al, Email: info@akm.go.al